

KONCEPTE DHE REKOMANDIME

për integrimin dhe zbatimin
e Kuadrit të Referencës
për Kompetencat për
Kulturë Demokratike
të Këshillit të Evropës në
programet e arsimit të lartë
dhe përgatitjen e mësuesve
në Universitetin e Tiranës, të
Durrësit dhe të Elbasanit

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

KONCEPTE DHE REKOMANDIME

për integrimin dhe zbatimin
e Kuadrit të Referencës
për Kompetencat për
Kulturë Demokratike
të Këshillit të Evropës në
programet e arsimit të lartë
dhe përgatitjen e mësuesve
në Universitetin e Tiranës, të
Durrësit dhe të Elbasanit

Mendimet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Riprodhimi i fragmenteve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, nëse nuk bëhet për qëllime komerciale dhe për aq kohë sa ruhet integriteti i tekstit, nuk nxirret jashtë kontekstit, nuk jep informacion të paplotë ose nuk e keqorienton lexuesin në lidhje me natyrën, objektin apo përmbajtjen e tekstit.

Përgatitur brenda fushës së zbatimit të projektit “Forcimi i edukimit për qytetari demokratike në Shqipëri”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida).

PËRMBAJTJA

KONTEKSTI, PROCESI, PARIMET DHE ARSYETIMI	5
Konteksti për konceptin	5
Konteksti ndërkombëtar dhe kombëtar	6
Procesi për zhvillimin e EKD-së	7
Arsyetimi	7
KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE	9
Parimet udhëzuese	9
QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT BAZUAR NË KOMPETENCA	11
STRUKTURA DHE PËRGJEGJËSITË E QEVERISJES	15
SI ZBATOHET NJË QASJE E PËRBASHKËT INSTITUCIONIT	17
Parimet kryesore	17
Katër hapa për ndërtimin e një kulture demokratike institucionale	17
REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E KUADRIT TË REFERENCËS PËR KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE	19
Ministria e Arsimit dhe Sportit	19
Universitetet dhe fakultetet e edukimit	20
<i>Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)</i>	21
<i>Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)</i>	21
<i>Qendra për Shërbimet Arsimore (QSHA)</i>	21
SHTOJCË: KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE	23
Vlerat	23
Qëndrimet	23
Aftësitë	23
Njohuritë dhe mirëkuptimi kritik	23
Informacione të rëndësishme për kontekstin	24

KONTEKSTI, PROCESI, PARIMET DHE ARSYETIMI

KONTEKSTI PËR KONCEPTIN

Edukimi për kulturë demokratike në arsimin e lartë në Shqipëri synon të kultivojë në brezat e ardhshëm profesionistë të të gjitha fushave, aftësi, njohuri, vlera dhe elemente të qytetarisë demokratike. Për këtë, referenca është e përditësuar me materialet që analizojnë dhe vlerësojnë nivelin e qytetarisë demokratike në arsimin formal në Shqipëri, integrimin në kurrikulën e arsimit të lartë për pedagogët në fakultetet e mësuesisë në universitetet e Tiranës, të Elbasanit dhe të Durrësit. Kjo analizë bazohet në rishikimin e dokumenteve kurrikulare, ndërsa objektivat e saj dhe rezultatet e të nxënit janë në përputhje me objektivat e përcaktuar në standardet dhe praktikatat e Këshillit të Evropës.

Vlerësimi u krye nga këndvështrimi i përgatitjes së mësuesve të ardhshëm, duke synuar përgatitje efektive në arsimin universitar, si dhe duke mbajtur parasysh si kusht të domosdoshëm, se sa më shpejt të ndërhyhet në procesin e përgatitjes fillestare të mësuesve, në plan të formimit të tyre me kulturë demokratike, aq më mirë përmbushet misioni i arsimit të lartë, si e mirë publike për funksionimin e demokracisë dhe përparimin e saj në shoqëri. Edhe dokumentet e Këshillit të Evropës, kryesisht «Kuatridhe referues i Kompetencave për Kulturë Demokratike – dokument udhëzues për arsimin e lartë» ishin po kaq të dobishëm në përpërgatitjen e këtij vlerësimi dhe hartimin e rekomandimeve.

Rezultoni se programet e edukimit, që ofrojnë fakultetet e mësuesisë të universiteteve të lartpërmendura, kanë shumë pak ngjashmëri midis tyre. Kurrikulat janë të mbingarkuara, si dhe u kushtohet pak vëmendje programeve ose lëndëve të veçanta si *Praktika profesionale* që studentët zhvillojnë në shkollë.

Mbikëqyrja e përvojës së studentëve në shkollë, nuk ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes, koordinimi dhe bashkëpunimi midis shkollës dhe fakultetit të edukimit është i dobët. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional dhe trajnimi gjatë punës duhet të harmonizohet me trajnimin fillestar, si dhe të nxitet nga kërkesa. Mbi të gjitha, studentët, mësuesit e ardhshëm, përballen me dy probleme të dallueshme:

- 1. Struktura të fragmentuara të programeve për përgatitjen e mësuesve.**
- 2. Ndryshime të shumta të cilësive të programeve, të metodologjive dhe të përmbajtjes së tyre nga njëri fakultet në tjetrin.**

Analiza dhe vlerësimi i situatës në këto fakultete të edukimit të mësuesve e bëjnë të domosdoshme përfshirjen në programe të kompetencave për kulturë demokratike për mësuesit e ardhshëm. Gjithashtu, në qendër të vëmendjes del nevoja që, përveç kuadrit të kompetencave, në programet për mësuesit e ardhshëm të përfshihen edhe disa standarde profesionale për përcaktimin e rezultateve të të nxënit në këto

programe dhe, më pas, edhe në përcaktimin e kriterëve të tjera për përzgjedhjen e punësimit fillestar të mësuesve, gjë që do të kontribuojë më pas në rritjen e cilësisë të arsimit të lartë të mësuesve në nivel kombëtar.

Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e mësipërm, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen e mësuesve të ardhshëm, lind si detyrë thelbësore harmonizimi në nivel kombëtar i këtyre programeve, detyrë që buron nga kërkesat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

Edukimi për kulturë demokratike është përfshirë në shumë instrumente dhe dokumente ndërkombëtare, të cilët theksojnë rëndësinë e edukimit dhe trajnimit për të drejtat e njeriut, liritë themelore, të drejtat demokratike dhe qytetare, po aq sa dhe rëndësinë e sundimit të ligjit. Aderimi dhe ratifikimi i dokumenteve kryesore ndërkombëtare, për edukimin e aspekteve të mësipërme, e bëjnë Shqipërinë përgjegjëse për respektimin e standardeve demokratike të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut, si dhe për përfshirjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe të të nxënimit në lidhje me këto çështje.

Në nivel evropian, Shqipëria, si nënshkruese e dokumentit të Edukimit për Qytetarinë Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut, raporton vazhdimisht mbi zbatimin e tij. Duke ndjekur rekomandimet¹ për qeveritë dhe shtetet anëtare, për të shndërruar objektivin parësor të edukimit të kulturës demokratike (EKD) në politikën dhe reformat arsimore, Shqipëria është angazhuar në rishikimin dhe përditësimin e kuadrit të saj politik dhe ligjor. Sistemi i arsimit parauniversitar ka për qëllim që t’i krijojë kushte dhe mundësi nxënësve, që të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera të një shoqërie demokratike, ndër të tjera, përmes formësimit të vlerave kulturore dhe qytetare, zhvillimit të përgjegjësive për veten, për të tjerët dhe shoqërinë.

Gjithashtu, duke u nisur nga këndvështrimi i *Zhvillimit të Objektivave të Qëndrueshëm*, të quajtur ndryshe *Agjenda 2030*, edukimi për kulturë demokratike kontribuon në qëllimet dhe grupet e synuara, duke përfshirë edhe arsimin cilësor.

Referuar kontekstit ndërkombëtar dhe kombëtar, në veçanti «Kuadrit Referues të Kompetencave për Kulturë Demokratike», analiza e mësipërme na jep një pasqyrë të situatës së edukimit për kulturë demokratike në sistemin arsimor shqiptar, në programet e përgatitjes së mësuesve në të tre universitetet: Tiranë, Elbasan dhe Durrës, si dhe bën thirrje për të ndërmarrë masa që përmirësojnë situatën.

1. Rekomandimi (82002) 12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi edukimin për qytetarinë demokratike.

PROCESI PËR ZHVILLIMIN E EDUKIMIT PËR KULTURË DEMOKRATIKE

Procesi i zhvillimit dhe i kultivimit të vlerave përmes edukimit për kulturë demokratike ka kaluar përgjatë rishikimit të dokumenteve, që pasqyrojnë gjetjet dhe rekomandimet, të cilat vlerësohen dhe përditësohen pas konsultimeve dhe tryezave të rrumbullakëta, në kuadër të këtij projekti. Ndër konceptet kryesore, që janë hulumtuar në programet e studimit dhe në kurrikulat për përgatitjen fillestare të mësuesve, janë:

- ▶ Demokracia,
- ▶ Pjesëmarrja,
- ▶ Bashkëpunimi,
- ▶ Kompetenca,
- ▶ Barazia,
- ▶ Toleranca,
- ▶ Të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Vitet e fundit, janë bërë shumë përpjekje e janë ndërmarrë veprimtari të ndryshme bashkëpunuese, që arsimit të lartë në Shqipëri të përafrohet me standardet ndërkombëtare, me synimin për të maksimizuar përfshirjen e arsimit tonë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Pavarësisht përpjekjeve, shumë aspekte të arsimit të lartë, në veçanti, cilësia e mësimdhënies, përmbajtja kurrikulare dhe kërkimi shkencor në institucionet e arsimit të lartë, herë pas here janë përballur me sfida, për shkak se nuk u janë përgjigjur nevojave sociale dhe zhvillimit kulturor e ekonomik të vendit.

ARSYETIMI

Programet e studimit për përgatitjen fillestare të mësuesve kanë pësuar reforma rishikuese, por, edhe pse është ndërhyrë për unifikim dhe harmonizim në nivel kombëtar, përmes një udhëzimi administrativ të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në korrik të vitit 2008 (me numer 29, i cili iu dërgua të gjitha universiteteve që përgatisin mësues, por nuk u botua në fletoren zyrtare), përsëri kurrikulat ndryshojnë nga njëri fakultet në tjetrin. Analiza e ndërmarrë për këtë qëllim ka evidentuar qartë se qasja e kurrikulës në këto programe është e orientuar drejt njohurive dhe pjesërisht e bazuar tek objektivat, rezultatet e të nxënimit dhe kompetencat. Edhe termi *kompetencë* përdoret në mënyrë të rastësishme dhe të paqartë. Në tërësi, objektivat ose rezultatet e të nxënimit, të kursit të studimit, shprehen në aspektin e njohurive dhe në disa raste edhe të aftësive. Kurrikula e bazuar te kompetencat, që formon bazën e sistemit të arsimit parauniversitar, nuk është e tillë në arsimin e lartë. Universitetet, më konkretisht fakultetet e edukimit, nuk i kanë reflektuar ende në programet e tyre këto aspekte konceptuale të arsimit parauniversitar. Këto çështje kanë si koncept bazë kompetencat në arsim, ndërkohë që mjediset didaktike, struktura dhe përmbajtja e programeve dhe e kurseve të studimit, planifikimi i mësimdhënies bazohen te kompetencat, vlerësimi i studentëve dhe përcaktimi i niveleve të arritjeve.

Është e nevojshme që studentët, si mësues të ardhshëm, të përvetësojnë njohuri të thella në programet universitare dhe parauniversitare për arritjen e kompetencave të kulturës demokratike, që lidhen me të drejtat e njeriut, demokracinë, qytetarinë, pjesëmarrjen, përfshirjen, bashkëpunimin, zgjidhjen e konflikteve, mendimin kritik etj.

KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE

PARIMET UDHËZUESE

Arsimi i lartë, si arsimi në përgjithësi, luan rol themelor në zhvillimin dhe ruajtjen e shoqërisë demokratike. Modeli i kompetencës për kulturë demokratike, i klasifikuar në katër fusha kryesore – vlerat, qëndrimet, aftësitë, njohuritë dhe të kuptuarit kritik – përmban njëzet² të tilla, të cilat duhet të zotërohen prej individit, që të jetojë si qytetar kompetent, në mënyrë demokratike dhe ndërkulturore.

Arsimi i lartë kujdeset për kulturën demokratike përmes kompetencave të tërthorta, që zhvillon me studentët, si për shembull: mënyra e ndërveprimit të tyre si aktorë të shoqërisë në kuptimin e saj më të gjerë. Kompetencat për kulturë demokratike nuk mund të zhvillohen disa orë në javë dhe më pas, me kalimin e kohës, të zbehen, sepse nuk ushtrohen. Ato nuk mund të zhvillohen vetëm në disa lëndë, si: *Psikologjia, Teoria e edukimit apo Qytetaria demokratike* dhe të harrohen kur mësohen lëndë të tjera, si: *Psikologjia e edukimit, Metodologjia e mësimdhënies, Vlerësimi, Metodat e kërkimit* etj. Zbatimi i plotë i kornizës për edukimin e kulturës demokratike kërkon një qasje institucionale gjithëpërfshirëse për promovimin dhe kujdesin e kësaj kulture si prioritet i politikave të arsimit në teori dhe në praktikë dhe jo të konsiderohet vetëm si disiplinë akademike.

Hartuesit e politikave dhe stafi akademik, që janë të përfshirë në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e arsimit të lartë, duhet të rrisin më tej rolin e tyre në kultivimin e vlerave, qëndrimeve, aftësive dhe të njohurive e të kuptuarit kritik, të vlefshëm për zhvillimin dhe përmirësimin e kulturës demokratike. Kjo do të arrihet kur në këtë proces të përfshihet në mënyrë aktive stafi akademik, studentët, administratorët dhe kancelarët në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga rektorët, dekanët, drejtuesit e njësive bazë/departamenteve, drejtuesit e stafeve akademike dhe kërkimore-shkencore. Gjithashtu, mbetet tepër e rëndësishme përfshirja e hartuesve të politikave, të zyrtarëve të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të përfaqësuesve të autoriteteve publike, të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), si dhe të bordeve me mandat publik për arsimin.

2. Shihni kategorizimin dhe listën në shtojcë.

QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT BAZUAR NË KOMPETENCA

Ky koncept, përveç përvijimit të mundësive të përdorimit të kuadrit të kompetencave për kulturë demokratike në të gjitha disiplinat akademike dhe në të gjitha programet, ka për qëllim të orientojë strukturat universitare dhe politikëbërëse në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për zhvillimin e këtyre kompetencave. Është e nevojshme që kompetencat të ndërtohen sipas një qasjeje institucionale holistike, në të gjitha aspektet e institucionit të arsimit të lartë dhe jo përmes kursesh a programesh të veçanta.

Kuadri i Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike të Këshillit të Europës, në arsimin e lartë, lidhet me kontekste më të specializuara, si me përgatitjen pedagogjike të mësuesve në arsimin e lartë. Në arsimin e lartë, kompetencat për kulturë demokratike zhvillohen në tri mënyra kryesore, përmes:

- ▶ trajnimit të specializuar të mësuesve për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm;
- ▶ trajnimit pedagogjik të instruktorëve të arsimit të lartë (ata që trajnojnë personelin akademik, të angazhuar me mësimdhënie në arsimin e lartë përmes programeve të zhvillimit profesional të pedagogëve);
- ▶ zhvillimit të kompetencave për kulturë demokratike nga të gjithë pjesëmarrësit në arsimin e lartë, duke përfshirë studentët, stafin akademik dhe atë administrativ.

Arsimi i lartë ndryshon nga arsimi parauniversitar, pasi ai luan një rol kryesor në prodhimin e dijeve përmes kërkimit shkencor, i cili, përtej horizontit profesional të studentëve, përbën një nga funksionet kryesore të edukimit të tyre si qytetarë të ardhshëm, për të kuptuar zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, strukturat dhe proceset politike të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, kompetencat për kulturë demokratike në arsimin e lartë, kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik, në mënyrë që studentët, si mësues të ardhshëm, të kuptojnë se si ndërtohen dhe krijohen njohuritë, të cilat janë tipare të të mësuarit në shoqërinë e dijes dhe në epokën digjitale.

Universitetet kanë lirinë dhe, në të njëjtën kohë, përgjegjësinë për t'i projektuar veprimtaritë e tyre brenda kufijve të instrumenteve dhe dokumenteve rregullatore, të zbatueshme në nivel kombëtar dhe në përputhje me disiplinat dhe standardet profesionale specifike, duke përfshirë udhëzimet e akreditimit dhe standardet e sigurimit të cilësisë.

Çfarë do të mbështesë programi? Programet e studimit të arsimit të lartë, të bazuara në kompetenca, duhet të shndërrohen në një qasje mbizotëruese të programeve të

studimit. Kjo lidhet ngushtë me aspektin e mësimdhënies dhe të të nxëniet, i cili do t'u mundësojë studentëve, që, përmes veprimtarive efektive të të mësuarit, të zhvillojnë kompetenca që përbushin aspiratat e tyre profesionale, si dhe nevojat shoqërore.

Një nga objektivat e programeve të studimit, të bazuar në kompetenca është përshtatja me qasje të ndryshme metodologjike të mësimdhënies dhe të nxënies, por edhe vlerësimi në të gjitha institucionet tona të arsimit të lartë. Në mënyrë më të përgjithshme, disa nga këto cilësi dhe aftësi, që do të ndërtohen dhe do të zhvillohen në përputhje me kompetencat, janë:

- ▶ aftësia për të qenë kritik dhe autokritik;
- ▶ aftësia për të treguar ndërgjegjësimin për mundësi e barabarta;
- ▶ aftësia për të vepruar në bazë të arsytimit etik;
- ▶ aftësitë ndërvetjake dhe të ndërvetimit;
- ▶ aftësia për të vepruar me përgjegjësi shoqërore dhe vetëdije qytetare.

Shumë institucione evropiane, madje edhe më gjerë, kanë përdorur metodologjinë *Tuning*³ për përditësimin e programeve të studimit, duke promovuar kështu mësimdhënien dhe nxënien, që përfshin kompetenca për kulturë demokratike. Pa dyshim, kjo duhet të ndodhë edhe në institucionet tona të arsimit të lartë.

Përfshirja e kompetencave për kulturë demokratike në programet e studimit bëhet të paktën në tri mënyra:

- ▶ në formën e një kursi ose kursi të vetëm modular;
- ▶ në lëndë të ndryshme;
- ▶ si një temë e tërthortë, që përfshihet në të gjitha temat ose në disa nga temat disiplinore.

Përzgjidhja e metodës varet nga situata të veçanta; në kushtet tona, mënyra e dytë dhe e tretë janë më të frytshme për arritjen e rezultateve të synuara. Mënyra e parë lidhet me programet ku kompetencat për kulturë demokratike janë në qendër të përvojës shkollore, pra trajnimi i mësuesve. Nëse ato do të përfshihen në një lëndë të vetme, ekziston rreziku i minimizimit ose i zhvendosjes së përgjegjësisë për këtë fushë në komponentët e tjerë të kurrikulës. Zhvillimi i edukimit të kompetencave për kulturë demokratike është proces kompleks, prandaj kjo nismë ndërdisiplinore ka nevojë të mbështetet si një nismë që përshkon gjithë kurrikulën. Këto qasje ndërvetjake dhe aktive për mësimdhënien dhe nxënien janë të përshtatshme për zhvillimin dhe praktikimin e kompetencave për kulturë demokratike. Ato, përveçse në mjediset mësimore, ndikojnë shumë te studentët, duke u krijuar mundësi që, përmes ushtrimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut, të mësojnë në auditor, pastaj, në klasë dhe jashtë saj, si dhe në shoqëri.

Këto qasje të mësimdhënies dhe të nxënies, të bazuara në kompetenca, krijojnë mundësi për studentët, mësuesit e ardhshëm, që të marrin pjesë në forma të ndryshme të të mësuarit bashkëpunues në të gjithë kurrikulën dhe të përdorin forma

3. <http://www.unideusto.org/tuningeu/competences/generic.html>

të ndryshme të punës në grup. Mësimi bashkëpunues ofron mundësi të mëdha, veçanërisht, në lidhje me mësimin e bazuar në projekte. Në kushtet tona, mënyra e dytë dhe e tretë janë më efektive në arritjen e rezultateve të synuara.

Praktikat demokratike të mësimdhënies dhe të nxënies zhvillojnë kompetenca, të cilat:

- ▶ mbështesin zhvillimin e vetefikasitetit dhe të empatisë;
- ▶ nxisin aftësitë analitike dhe të të menduarit kritik;
- ▶ zhvillojnë tolerancën ndaj paqartësive;
- ▶ kontribuojnë në vlerësimin e demokracisë dhe të drejtësisë;
- ▶ forcojnë njohuritë dhe të kuptuarit kritik të temës së diskutuar.

STRUKTURA DHE PËRGJEGJËSITË E QEVERISJES

Zhvillimi i kulturës demokratike nuk mund të kuptohet pa ekzistencën dhe funksionimin e strukturave institucionale. Në universitete, studentët mishërojnë vlerat, qëndrimet, aftësitë, mendimin kritik, njohuritë dhe mirëkuptimin, në mënyrë që të marrin pjesë aktive dhe të kontribuojnë në jetën shoqërore.

Ekzistojnë dy nivele kryesore qeverisjeje në arsimin e lartë, në sistem dhe në institucion. Qeverisja luan një rol të spikatur në krijimin e një mjedisi demokratik dhe ndërtohet brenda një trekëndëshi të përshkruar nga aspiratat akademike, forcat e tregut dhe kultura demokratike. Mirëqeverisja në institucionet e arsimit të lartë realizohet kur përzgjidhen dhe zbatohen strategji dhe instrumente ose kurse studimi, për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuar, të cilët në fund i shërbejnë interesave të gjithë shoqërisë.

Liria akademike dhe autonomia institucionale mbeten vlera thelbësore të arsimit të lartë për zhvillimin dhe arritjen e kompetencave për kulturë demokratike.

Institucionet e arsimit të lartë shpesh perceptohen si mjedise të kushtueshme për zhvillimin profesional, tejet akademike dhe shumë përtej situatës aktuale në shkolla, në vend që të vështrohen si qendra për zhvillimin dhe shkëmbimin e njohurive dhe të të kuptuarit të dukurive. Ato duhet të bëhen qendrat kryesore të promovimit dhe të zhvillimit të kompetencave për edukimin e kulturës demokratike.

Sigurimi i cilësisë kërkon përgjegjësi nga aktorë të ndryshëm. Autoritetet e institucioneve të arsimit të lartë kanë përgjegjësinë të garantojnë kornizat e sigurimit të cilësisë në nivel sistemi, në mënyrë që të përmirësojnë «kulturën e cilësisë», që duhet të zotërojnë në mjediset universitare. Drejtuesit institucionalë luajnë rol kryesor në avancimin e procedurave dhe të mekanizmave të sigurimit të cilësisë brenda institucionit ku ata veprojnë. Do të ishte e pamundur të perceptohej një mjedis universitar, që synon përmirësimin e cilësisë brenda institucionit të arsimit të lartë, pa zbatimin e plotë të kompetencave për kulturën demokratike.

Lidershipi institucional duhet të përgatisë agjendën për qytetarinë dhe demokracinë, një nga parimet e saj udhëheqëse për të siguruar koherencë brenda vizionit dhe misionit institucional. Për aq kohë sa lidershipi nuk i jep përparësi kulturës demokratike, përparimi në zhvillimin e kulturës institucionale është i pamundur.

Personeli akademik duhet të jetë i vetëdijshëm për rolin e tij në përgatitjen e qytetarëve të ardhshëm dhe, në të njëjtën kohë, të jenë qytetarë që kontribuojnë në komunitet dhe në shoqëri. Përgjegjësia për zhvillimin e kompetencave për kulturë demokratike, në të gjitha disiplinat, bie mbi stafin akademik.

Një qasje institucionale holistike, për zhvillimin e kompetencave për kulturën demokratike, do të bëjë të mundur që të gjithë aspektet e arsimit të lartë, si: kurrikulat,

metodat dhe burimet e mësimdhënies, metodat e kërkimit shkencor dhe punës ndërvepruese, strukturat drejtuese dhe vendimmarrëse etj., të pasqyrojnë parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut.

Institucionet e arsimit të lartë luajnë një rol kyç në ndërtimin dhe prodhimin e njohurive të reja përmes kërkimit, që përben një nga funksionet e tyre kryesore, krahas atij të mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera që ofrojnë. Hulumtimi universitar mund dhe duhet të luajë një rol thelbësor në edukimin për kompetencat për kulturën demokratike, nëpërmjet:

- ▶ sigurimit të njohurive të reja të përftuara nga studentët si qytetarë të ardhshëm, në mënyrë që të kuptojnë aspekte të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë, shoqërisë dhe politikës, si dhe proceset që i shoqërojnë ata;
- ▶ kontributit në përvetësimin e aftësive të të menduarit kritik nga studentët dhe angazhimin e tyre në kërkime, për të kuptuar se si ndërtohen njohuritë, si komunikohen dhe si përdoren ato në fusha të ndryshme të shoqërisë;
- ▶ përgatitjes së brezit të ri të kërkuesve, për sa kohë kërkimi në arsim përfshin jo vetëm ndërtimin e njohurive teorike, të teknikave dhe metodave të kërkimit, por edhe mëson aspektet etike dhe sociale të veprimtarive kërkimore dhe ndikimin e tyre.

SI ZBATOHEK NJË QASJE E PËRBASHKËT INSTITUCIONIT

Në nivel praktikimi, zbatimi i një qasjeje nga i gjithë institucioni, për zhvillimin e kompetencave të kulturës demokratike, e zhvendos fokusin nga kompetencat individuale të ndërtimit i një mjedisi mësimor demokratik, ku kompetencat mund të mësohen, të zhvillohen dhe të praktikohen. Ka shumë mënyra për të zbatuar qasjen holistike institucionale në arsimin e lartë. Më poshtë po renditim disa nga parimet kryesore dhe hapat e mundshëm për zbatim.

PARIMET KRYESORE:

- ▶ Respekti për kontekstin vendor. Kultura demokratike nuk mund të imponohet nga jashtë, por duhet të ndërtohet nga vetë stafi akademik dhe nga vetë lidershpi.
- ▶ Fuqizimi i aktorëve për të gjetur dhe për të praktikuar zgjidhje për sfidat e ndryshme, duke u bazuar në vlerësimin e situatës.
- ▶ Inkurajimi i «të mësuarit përmes të vepruarit». Kompetencat demokratike zhvillohen më mirë përmes praktikës së përditshme, duke përfshirë vendimmarrjen me pjesëmarrje dhe metodat demokratike të mësimdhënies dhe të nxënies.
- ▶ Integrimi i ngritjes së kapaciteteve në procesin e planifikimit strategjik të institucionit.
- ▶ Mbështetja e projekteve dhe nismave me plan afatgjatë. Ndryshimet sistematike kërkojnë përpjekje të përbashkëta dhe mbështetje afatgjatë, për të arritur rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme.

KATËR HAPA PËR NDËRTIMIN E NJË KULTURE DEMOKRATIKE INSTITUCIONALE

Një institucion mund të ndërmarrë katër hapa për t'u bërë më demokratik, duke zbatuar një qasje institucionale holistike në ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencës së kulturës demokratike institucionale të studentëve-mësuesve të ardhshëm.

- ▶ Identifikimi i mënyrave të integritit të parimeve të demokracisë në jetën institucionale, duke u bazuar në analizën e situatës.
- ▶ Identifikimi i fushave për ndryshim dhe zhvillim i një plani veprimi me veprimtari konkrete.
- ▶ Zbatimi i planit të veprimit, duke përfshirë të gjitha komunitetet e arsimit të lartë.
- ▶ Vlerësimi i progresit dhe i ndikimit të veprimeve të ndërmarra.

Një qasje e tillë institucionale kërkon angazhim, motivim dhe përfshirje të të gjitha palëve të interesuara, të cilat, në mënyrë të pashmangshme, do të çojnë në kushte më të mira pune dhe jetese për të gjithë.

REKOMANDIME PËR ZBATIMIN E KUADRIT TË REFERENCËS PËR KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE

Veprimet që duhen ndërmarrë për zbatimin dhe zhvillimin e kompetencave përfshijnë të gjithë aktorët, politikëbërësit, institucionet, akademikët dhe profesionistët e të gjitha niveleve.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Ministria e Arsimit dhe Sportit, si institucioni përgjegjës për politikën arsimore – në lidhje me hartimin e politikave, respektimin e autonomisë institucionale dhe akademike në arsimin e lartë, interesimin për cilësinë e përgatitjes së brezave, qytetarëve të ardhshëm të shoqërisë – përveç cilësive profesionale të mësuesve duhet, gjithashtu, të kujdeset për cilësinë në arritjen e kompetencave për edukimin e studentëve me kulturë demokratike.

Prandaj, institucionet në varësinë e saj, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL); Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) dhe Qendra për Shërbimet Arsimore (QSHA), është e nevojshme të orientohen që të përfshijnë këto kompetenca në **programet e trajnimit për zhvillimin profesional të mësuesve, në vlerësimin e performancës dhe në kriteret e rekrutimit të mësuesve përmes procesit të licensimit.**

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të marrë nismën legjislative për të përfshirë në aktet ligjore standardet e cilësisë, si dhe kompetencat për edukimin demokratik kulturor.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe autoritetet arsimore, pra, qeveria, ka rol thelbësor në mbarëvajtjen dhe promovimin e një sistemi efektiv për zhvillimin e kompetencave për kulturën demokratike, prandaj duhet:

- i. të hartojë një politikë të shkruar, që shpreh angazhimin për një qasje kombëtare në edukimin e mësuesve dhe formimin e tyre, duke u bazuar në kompetencën e kulturës demokratike;
- ii. të marrë masat për zbatimin e politikave arsimore të mbikëqyrura nga organet kombëtare të koordinimit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, universitetet, ASCAL-ja, ASCAP-ja, QSHA-ja, organet kompetente;
- iii. të mbështesë decentralizimin e kurrikulave të cilat, në përputhje me kapacitetit e çdo institucioni dhe të rrethanave të tyre vendore, krijojnë më shumë hapësirë për përmirësime.

UNIVERSITETET DHE FAKULTETET E EDUKIMIT

Programet e studimit që përfshihen në të gjitha kurrikulat e kurseve duhet të përfshijnë rezultatet e të nxënësve, që kontribuojnë në arritjen e kompetencave për arsimin, për kulturën demokratike, të integruara në rezultatet specifike të secilit planprogram (*sillabus*).

Fakultetet e edukimit dhe agjencitë e trajnimit të mësuesve duhet të fillojnë të marrin rol lidhës, si dhe të bëhen faktorë të ndryshimit, në mënyrë që transformimi shoqëror të vijë përmes edukimit të studentëve me kulturë demokratike. Meqenëse mësuesit konsiderohen burimi kryesor njerëzor, për sa i përket zhvillimit të vendit, është e rëndësishme që ata të përgatiten sa më mirë e me kompetenca për kulturën demokratike, përveç kompetencave të mësimdhënies gjatë programit të trajnimit, para se të fillojnë punën si mësues, si dhe gjatë zhvillimit të tyre të vazhdueshëm profesional.

- i. Fakultetet e edukimit duhet të rishikojnë *sillabuset* dhe programet mësimore, në mënyrë që të integrojnë në to kompetencat për kulturën demokratike, përveç atyre që lidhen me përmbajtjen specifike.
- ii. Fakultetet e edukimit duhet të zhvillojnë veprimtari trajnuese për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.
- iii. Drejtuesit e shkollave dhe institucionet e tjera arsimore duhet t'i pajisin mësuesit me aftësi për zhvillimin dhe angazhimin në kompetencat e mësimdhënies dhe nxënies për edukimin e kulturës demokratike. Në programet e tyre të trajnimit, si në «Shkollën e drejtorëve», edukimi për kulturë demokratike duhet të integrohet me temat e tjera.
- iv. Fakultetet e edukimit të ndërtojnë një sistem funksional partneriteti me shkollën për përvojën shkollore të studentëve gjatë viteve të përgatitjes, ku ndër qëllimet profesionale të kursit, në zhvillimin e procesit të mësimdhënies dhe nxënies, duhet të përfshihen edhe kompetencat për edukimin e kulturës demokratike.
- v. Fakultetet e edukimit duhet të hartojnë dhe të zbatojnë një program trajnimi për mësuesit mentorë, të cilët i udhëzojnë studentët-mësuesit e ardhshëm, në përvojën e shkollës, në të gjitha fazat, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave për kulturën demokratike.
Mësuesit mentorë duhet të pajisen me njohuri dhe aftësi për t'i ndihmuar studentët-mësuesit e ardhshëm, se si të mësojnë rreth profesionit. Përveç kompetencave didaktike, kjo do të thotë se ata duhet të jenë në gjendje ta planifikojnë dhe ta japin mësimin kur në shumë raste u mungojnë kompetencat sociale. Kjo do të thotë se kur studentë të tillë bëhen mësues, do të ishte e pamundur që ata të ishin në gjendje të zhvillonin aftësitë socio-emocionale të të mësuarit të nxënësve të tyre, nëse nuk i kanë përvetësuar vetë ato aftësi gjatë studimeve.
- vi. Fakultetet e edukimit duhet të hartojnë dhe të zbatojnë një program të trajnimit të stafit akademik (programi i zhvillimit të Fakultetit), për zbatimin e kompetencave për edukimin e kulturës demokratike në programet dhe kurrikulat e tyre, nga instruktorët që i kanë këto njohuri dhe aftësi.

- vii.** Fakultetet e edukimit duhet t'i inkurajojnë studentët, që në përgatitjen e e tezës së diplomës, të trajtojnë edhe tema që përmbajnë zhvillimin e kompetencave të kulturës demokratike.
- viii.** Vlerësimi i tezës dhe i punimeve të tjera në lidhje me kulturën demokratike duhet të bazohet në një proces vlerësimi mes kolegësh.

Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)

Duhet:

- i.** të përfshijë në kriteret e vlerësimit dhe të akreditimit të programeve të studimit për profesionin e mësuesisë, kompetenca të edukimit të kulturës demokratike në të gjitha programet e lëndëve, në mënyrë që të përshkojnë të gjithë kurrikulën;
- ii.** të monitorojë standardet e performancës së mësuesve në lidhje me arritjet e kompetencave për kulturë demokratike.

Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP)

Duhet:

- i.** të zhvillojë mekanizmat e sigurimit të cilësisë;
- ii.** t'i kushtojë vëmendje pasurimit të standardeve të cilësisë në programet e studimit, duke përfshirë kompetencat për kulturë demokratike në programet e përgatitjes së mësuesve;
- iii.** të krijojë metoda të përshtatshme për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave të mësuesve në edukimin për kulturë demokratike;
- iv.** të vlerësojë dhe monitorojë nismat e trajnimit të mësuesve për edukimin qytetar në nivel kombëtar, përmes programeve që zhvillojnë kompetencat për kulturë demokratike;
- v.** të inkurajojë bashkëpunim më të ngushtë midis institucioneve të përfshira në mësimdhënie, në trajnimin për edukimin qytetar, duke përfshirë, fakultetet e edukimit, agjencitë e trajnimit dhe autoritetet arsimore.

Qendra për Shërbimet Arsimore (QSHA)

Duhet:

- i.** të përfshijë standarde të veçanta të kompetencave për kulturë demokratike, në testimin kualifikues të së drejtës së ushtrimit të profesionit të mësuesisë, që do të kenë efekt të rëndësishëm në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies.

SHTOJCË: KOMPETENCAT PËR KULTURË DEMOKRATIKE

VLERAT:

- ▶ Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe i të drejtave të njeriut
- ▶ Vlerësimi i diversitetit kulturor
- ▶ Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, barazisë dhe sundimit të ligjit

QËNDRIMET:

- ▶ Hapja ndaj tjetërsisë kulturore dhe besimeve të tjera, pikëpamjeve dhe praktikave të ndryshme të botës
- ▶ Respekti
- ▶ Mendësia qytetare
- ▶ Përgjegjësia
- ▶ Vetëfikasiteti
- ▶ Toleranca dhe paqartësia

AFTËSITË:

- ▶ Aftësitë e të mësuarit autodidakt
- ▶ Aftësitë analitike dhe të menduarit kritik
- ▶ Aftësitë për të dëgjuar dhe për të vëzhguar
- ▶ Empatia
- ▶ Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria
- ▶ Aftësitë gjuhësore, komunikuese dhe shumëgjuhëshe
- ▶ Aftësitë e bashkëpunimit
- ▶ Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve

NJOHURITË DHE MIRËKUPTIMI KRITIK:

- ▶ Njohuritë dhe të kuptuarit kritik të vetvetes
- ▶ Njohuritë dhe kuptimi kritik i gjuhës dhe i komunikimit
- ▶ Njohja dhe të kuptuarit kritik të botës: politika, ligji, të drejtat e njeriut, kulturat, fetë, historia, media, ekonomitë, mjedisi, qëndrueshmëria

INFORMACIONE TË RËNDËSISHME PËR KONTEKSTIN:

- ▶ Vlerësimi i kurrikulës së arsimit të lartë sipas perspektivës së përgatitjes profesionale të mësimeve të ardhshme për edukimin efektiv të EQD-së/ EDNJ-së në përputhje me standardet e KiE-së, Këshilli i Europës, 2021
- ▶ Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendimi nr. 531 i Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, 11.9.2018
- ▶ Vlerësimi i nivelit të qytetarisë demokratike në edukimin formal qytetar në Shqipëri, përmes analizës së kurrikulës dhe objektivat e të mësuarit të lëndëve të edukimit qytetar, si dhe harmonizimi i tyre me standardet dhe praktikat e Këshillit të Evropës, Këshilli i Europës, 2021
- ▶ Konferenca Informale e Ministrave të Arsimit, e organizuar nën Kryesinë Greke të Komitetit të Ministrave – Përgjigja e arsimit ndaj krizës së COVID, Deklarata politike, 29 tetor 2020
- ▶ Ligji për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, nr. 80/2015
- ▶ Kuadri i Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike (vëllimet 1, 2, 3), Këshilli i Evropës, 2018
- ▶ Kuadri i Referencës për Kompetencat për Kulturë Demokratike (KRKKD), Këshilli i Europës, 2020
- ▶ Zgaga, P. (2006), «Rishqyrtimi i administrimit të arsimit të lartë». - Në: Kohler J. dhe Huber J. (red.) (2006), Administrimi i arsimit të lartë midis kulturës demokratike, aspiratave akademike dhe forcave të tregut, Seritë e Arsimit të Lartë të Këshillit të Evropës, nr. 5, f. 35-50.

Faqe interneti:

- www.coe.int/en/web/education/competences-for-democratic-culture
- <https://www.unideusto.org/tuningeu/>
- <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf>

Për të lexuar:

Një listë publikimesh të tjera të rëndësishme në faqen e KKD-së të Këshillit të Evropës.

- <https://www.coe.int/en/web/reference-framework-of-competences-for-democratic-culture>

Për më tepër informacion:

 <https://www.coe.int/sq/web/tirana/home>

 Council of Europe Office in Tirana

 coe_tirana

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE